

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.U. nga fshati ... komuna e Gjilanit, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i saj B.D., për shkak të mos pagesës së pagave pas pensionimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.695/2012, të datës 29.09.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 17.09.2016, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.695/2012, i datës 29.09.2015, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.695/2012, të datës 29.09.2015, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit H.U. nga fshati ... komuna e Gjilanit dhe e ka obliguar të paditurën Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim në Gjilan, që paditësit H.U. në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj shumën e mjeteve monetare prej 241.42 €, kurse në emër të përcjelljes në pension t'ia paguaj shumën e mjeteve monetare prej 241.42 €, me kamatë prej 3.2 %. Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit H.U. nga nga fshati ... komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim në Gjilan që paditësit H.U. në emër të regresit t'ia paguaj shumën e mjeteve monetare prej 120 €, me kamatë prej 3.2 %.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.695/2012, të datës 29.09.2015, përkatësisht pikën I të këtij aktgjykimi dhe ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ose ta prishë këtë aktgjykim në pikën I dhe ta kthej çështjen në rigjykim.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi H.U. me datë 04.10.2011, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim, për shkak të mos pagesës së pagave pas pensionimit, me arsye sikurse në padi.

E paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim në përgjigje në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit nga arsyeja se paditësi kërkesëpadinë e bazon në Kontratën Kolektive të miratuar dhe të nënshkruar nga BSPK, Qeveria e Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës ndërsa Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Arsim si e paditur në rastin konkret nuk është palë kontraktuese respektivisht nënshkruese e Kontratës së Përgjithshme Kolektive, më gjerësisht sikurse në përgjigje në padi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.695/2012, të datës 29.09.2015, me të cilën pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve se e paditura me rastin e pensionimit nuk ia ka paguar paditësit dy paga si shpërblim jubilar si dhe regresin.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar gjykata ka arsyetuar se nga gjendja e vërtetuar faktike ka ardhur në përfundim se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës pastrues dhe atë në një periudhë kohore mbi 30 vite, kur edhe është pensionuar me datën 11.07.2007, ku në bazë të nenit 43 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive është paraparë se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesën përcjellëse në lartësi prej dy pagave minimale mujore të punëtorit në Kosovë për tre muajt e fundit, gjegjësisht dy paga mesatare të punëtorit për tre muajt e kaluar.

Lidhur me mënyrën e vendosjen si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar që ka të bëjë me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në rastin konkret paditësi me as një provë nuk ka arritur ta vërtetojë lartësinë e kërkesëpadisë në këtë pjesë.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata ju ka referuar neneve 43 dhe 44 të Kontratës Kolektive, e lidhur në mes të Qeverisë së Kosovës, Bashkimit të Sindikatave të Pavarurua të Kosovës dhe Odës Ekonomike, e cila ka filluar së zbatuari me datë 01.01.2005.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarës së të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi ka qenë në marrdhënie pune tek e paditura dhe se kjo e fundit me rastin e pensionimit nuk i'a ka paguar paditësit dy paga si shpërblim jubilar si dhe regresin.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë pasi që nga shkresat e lëndës rezulton së nuk ka qenë rrethanë kontestuese fakti se paditësi ka qenë në marrdhënie pune tek e paditura deri në arritjen e moshës së pensionit, përkatësisht deri me datën 11.07.2007. Kjo rrethanë është provuar edhe nga vendimi i të paditurës i datës 21.08.2007, për pensionimin e punëtorit, këtu paditësit. Kontrata Kolektive ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2005, me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite përkatësisht deri me datën 31.12.2007, kur të njëjtës i ka skaduar afati i zbatimit përkatësisht i ka pushuar efekti juridik. Edhe sipas dispozitës së nenit 6.4 të Ligjit Themelor të Punës përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe në pikën II të aktgjykimit të ankimuar, kur e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë e cila ka të bëjë me pagesën e regresit, sepse për këtë pjesë të kërkesëpadisë, paditësi nuk ka arritur ta argumentoj të drejtën e tij me asnjë provë relevante konkrete.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.4446/15, me datën 17.09.2018**

**Kryetari i kolegjit – Gjyqtari,**  
**Valon Totaj**